



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:121654

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06600187

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurve Ha.Xh dhe Hy.Xh që të dy me vendbanim në Rr. “E.K” në Sh..., duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND.170/24, të datës 05.12.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurve Ha.Xh dhe Hy.Xh, në një të anë dhe përfaqësuesit të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik sektori i pylltarisë - Komuna e Shtimes me përfaqësues T.H, në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.846/22, të datës 14.06.2022, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 16.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.170/24, e datës 05.12.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit Ha.Xh, me vendbanim në Rr. “E.K” në Sh..., i lindur me datë ....., me numër personal....., të pandehurit Hy.Xh me vendbanim në Rr. “E.K” në Sh..., i lindur me datë ....., me numër personal ....., në një të anë dhe Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik sektori i pylltarisë - Komuna e Shtimes me përfaqësues –T.H.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.846/22 e datës 14.06.2022, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurve Ha.Xh dhe Hy.Xh, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.846/22 të datës 14.06.2022, e ka akuzuar të pandehurin Ha.Xh dhe Hy.Xh, për veprën penale në bashkëkryerje Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Më datë 01.10.2024, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor dhe në këtë shqyrtim bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 05.12.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 170/2024, në mes të pandehurit Ha.Xh, me vendbanim në Rr. “E.K” në Sh..., i lindur me datë ..., me numër personal ....., të pandehurit Hy.Xh me vendbanim në Rr. “E.K” në Sh..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në njërën anë dhe Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik sektori i pylltarisë - Komuna e Shtimes me përfaqësues –T.H.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**2022:121655, datë 16.12.2024**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

**Dardan Maloku**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.